

UDHËZIM
Nr.16, datë 10.10.2003

MBI PROCEDURËN E VOTIMIT TË ZGJEDHËSVE TË VEÇANTË

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 61 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi i këtij udhëzimi

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të votimit të zgjedhësve të veçantë, anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit, që janë të regjistruar në një qendër votimi të ndryshme nga ajo ku kanë vendbanimin ose vendqëndrimin brenda njësisë zgjedhore përkatëse.

Neni 2

Procedura e votimit

Të gjithë zgjedhësit që janë caktuar si anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit, në qendra votimi të ndryshme prej atyre ku ata kanë vendbanimin ose vendqëndrimin brenda njësisë zgjedhore përkatëse, evidentohen dhe regjistrohen prej KZQV-ve respektive në një listë të posaçme.

Kjo listë përmban të dhënat personale të secilit prej tyre, numrin e qendrës së votimit ku zgjedhësi i veçantë është regjistruar, si dhe atë ku ai është caktuar si anëtar i komisionit të qendrës së votimit.

Bazuar në këtë listë, KZQV-ja merr vendim për lejimin e zgjedhësit të veçantë për të votuar në qendrën e votimit ku ai është anëtar i KQV-së, dhe për të mos e lejuar atë të votojë në qendrën e votimit ku ai ndodhet i regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Një kopje e vendimit i dërgohet KQV-së ku zgjedhësi është anëtar dhe një kopje tjetër KQV-së ku zgjedhësi është regjistruar në listën e zgjedhësve.

Neni 3

Anëtarët e KQV-së do të votojnë në fund të votimit, kur të mos ketë më zgjedhës që presin të votojnë.

Neni 4

Modeli i vendimit të KQZ-së që lejon zgjedhësin e veçantë për të votuar në qendrën e votimit ku ai është anëtar i KQV-së, miratohet me vendim të KQZ-së.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.